



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli Audi Aktiengesellschaft / Ducati Motor Holdings S.p.a

Në datën 11 Maj 2012, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve ndërmjet shoqërive Audi Aktiengesellschaft dhe Ducati Motor Holdings S.p.a, më datë 18 Prill 2012, me objekt përfitim të kontrollit të vetëm në shoqëritë e Ducati Motor Holdings S.p.a nga shoqëria Audi Aktiengesellschaft me anë të transferimit të 100% të aksioneve.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Audi Aktiengesellschaft:** ushtron veprimtarinë e saj në dizenjimin, prodhimin, ofrimin dhe shpërndarje të automjeteve, në veçanti në segmentin premium si dhe në aktivitetin e prodhimit dhe shitjes së pjesëve të këmbimit etj,;
- **Ducati Motor Holdings S.p.a:** ushtron veprimtarinë e saj në fushën e projektimit, prodhimit, shpërndarjes dhe shitjen e motoçikletave si dhe në ofrimin e pjesëve të këmbimit , aksesorëve dhe mallrave nën markën Ducati.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b) dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al